



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr. 47/2018  
Prishtinë, më 6.11.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, dhe Veton Berisha, anëtarë. I pranishëm edhe Sali Zyba, deputet.

**Munguan:** Liburn Aliu, Hykmete Bajrami, dhe Duda Balje, anëtarë.

**I ftuar:** z. Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE).

**Pjesëmarrës tjerë:** Halit Hoxhaj, Shkumbin Asllani, Lorik Fejzullahu, Lulzim Demolli dhe Fidaim Sahiti, MZHE; Dardan Abazi, INDEP; Lumnije Hashani, OKE; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve; Edona Baliqi, KDI; Ahmet Geca dhe Gazmend Begolli, Komiteti Energjetik /VV; Vatra Qehaja, GP/VV; Shpresa Sejdiu, GP/ PSD dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.10.2018;
3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, lidhur me procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” dhe funksionalizimin e ndërmarrjes “TREPÇA” SH.A;
4. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.10.2018**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 30.10.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, lidhur me procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” dhe funksionalizimin e ndërmarrjes “TREPÇA” SH.A**

**Kryetarja** theksoi se me kërkesën e deputetit Dardan Sejdiu, mbështetur edhe nga deputetë tjerë, është ftuar z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, që të raportojë lidhur me procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” dhe funksionalizimin e ndërmarrjes “TREPÇA” SH.A. Lidhur me këtë, ia dha fjalën ministrit.

**Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik**, theksoi se duke u bazuar në Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2017-2026, si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Kombëtar, Kosova ka nevojë për kapacitete të reja gjeneruese të energjisë elektrike. Andaj, ne jemi të obliguar që t’i realizojmë dhe materializojmë strategjitë e vendit tonë për t’i ofruar vendit, ekonomisë dhe popullit të Kosovës, prosperitet dhe siguri në të gjitha fushat. Ai tha se më 20 dhjetor 2017 janë nënshkruar marrëveshjet komerciale me investitorin “ContourGlobal”. Kurse, tani në të gjitha aspektet jemi para mbylljes së fazës finale të projektit. Shpallja e tenderit nga investitori “ContourGlobal” për përzgjedhjen e kompanisë për projektim, inxhinierim dhe ndërtim, është bërë brenda afateve të parashikuara, më 22.6.2018. Kontratat komerciale janë bërë efektive, pas përmbylljes së disa aktiviteteve, më 24 maj 2018. Sigurimi i kredive për projektin është e paraparë deri në përfundim të mbylljes financiare, datë 24 muaj nga bërja efektive e marrëveshjeve komerciale. Në vazhden e aktiviteteve për realizimin e projektit TC “Kosova e Re”, në qershor 2018, investitori “ContourGlobal” ka hapur ftesën për parakualifikim për kompanitë e interesuara për EPC (Inxhinierim, projektim dhe ndërtim), si dhe LTMA (Mirëmbajtje afatgjate). Ka pasur një interesim jashtëzakonisht të madh të kompanive më të mëdha botërore për këtë proces, ku më 16 gusht 2018, “ContourGlobal” ka pranuar 6 oferta të kompanive dhe konsorciumeve, ku pas procesit të vlerësimit që ka bërë investitori, katër nga këto kompani janë parakualifikuar. Ofertuesit e parakualifikuar janë: konsorcium i kompanisë “General Electric”; konsorcium i përbërë nga “ENKA” dhe “Mitsubishi Hitachi”; konsorcium nga “Hyundai”, si dhe konsorciumi nga “CMEC”. Ai tha se këta ofertues, gjithashtu kanë ofruar furnizime me pajisje, si dhe shërbime afatgjata të mirëmbajtjes nga “Doosan”, “IHI Corporation Japan”, “Rafako”, “Siemens”, “Toshiba”, “Alstom”, “Técnicas Reunidas” e të tjera. Po ashtu, theksoi se 2 kompanitë që nuk janë parakualifikuar: “Doosan”, për shkak të mungesës së eksperiencës me termocentrale me linjit dhe “Dong Fang”, për arsye të mungesës së eksperiencës në EPC. Pas kësaj faze të suksesshme, ofertuesve të parakualifikuar iu është dorëzuar kërkesa për propozime, që do t’iu mundësojë atyre ta bëjnë ofertën teknike dhe financiare. Andaj, nëse çdo gjë shkon sipas një dinamike të paraparë, ne presim që në pjesën e

parë të vitit 2019 të fillojë ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re”. Struktura e financimit është e paraparë si vijon: Totali i kostos së projektit 1.3 miliard euro; ekuiteiti nga CG 400 milionë; financim nga agjencitë për financim të eksporteve, minimum 400 milionë euro; OPIC 400 – 500 milionë euro. Projekti TC “Kosova e Re” është projekti për të cilin janë bërë më së shumti studime dhe secili opion e nxjerrë TC “Kosova e Re”, si zgjidhje të domosdoshme. Kurse, studimi i opsioneve të fundit që ka bërë Banka Botërore, i cili ende nuk është publikuar, në draftin që kemi parë ne, shihet se është bërë me pasaktësi shumë të mëdha, për të cilat ne i kemi dhënë komentet e tona. Ai studim ka pasaktësi në llogaritje, jep si opion një teknologji e cila ende nuk është prodhuar e aq më pak e testuar, duke synuar që ta lë Kosovën në pritje të gjatë e ta kthejë vendin në një laborator testimesh. Për më tepër, ai studim edhe po të ishte i saktë, prapëseprapë Kosovën e lë importues të përherëshëm me rreth 18%-20% të nevojave vendore të energjisë. Si ministër i këtij vendi, përgjegjës për energji, nuk do të lejoj që Kosova të varet nga importet e energjisë. Strategji e vendit është që rritja ekonomike dhe punësimi të ndodhin në vend, duke shfrytëzuar potencialet e jashtëzakonshme vendore për gjenerim të energjisë, jo vetëm për nevoja tona, por edhe për eksport. Ne duhet të sigurojmë pavarësi energjetike dhe nuk ka alternativë tjetër, ashtu siç nuk kemi alternativa tjera për gjenerim të energjisë elektrike. “Kosova e Re” do të finalizohet, sepse është e vetmja zgjidhje për të arritur sigurinë e furnizimit me energji, që direkt ndikon në sigurinë nacionale të vendit. Ne do të avancojmë me projekte alternative nga burimet e ripërtëritshme, por nuk mund dhe as nuk guxojmë të eksperimentojmë me sigurinë e vendit. Në marrëveshjet komerciale janë paraparë edhe pasojat nga dështimi i mundshëm i këtij projekti. Varësisht se për faj të kujt, secila palë ka obligime dhe penallti të dakorduara. Mirëpo, këto detyrime janë të papërfillshme në raport me humbjet që në vazhdimësi ka Kosova, si pasojë e mosfurnizimit të rregullt me energji elektrike. Çdo vit, bizneset humbin nga 300 milionë euro, si pasojë e mungesës dhe pasigurisë së furnizimit. Kosova, si shumë palë tjera kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, ka orientuar politikat e veta afatmesme të sigurimit të furnizimit me energji në rezervat e linjtit. Të njëjtin orientim e kanë edhe vende tjera të Bashkimit Evropian. Termocentrale të tilla, me kapacitete edhe më të mëdha se “Kosova e Re”, sot operojnë apo edhe janë në fazë të projektimit ose ndërtimit në shumë vende të BE-së, siç është Gjermania, Çekia, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Polonia, Rumania, Bullgaria etj. Edhe fqinjët tanë, Serbia Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovinën, po ndërtojnë termocentrale nga linjiti. E përbashkëta e këtyre projekteve është se ato garantojnë respektimin e standardeve mjedisore evropiane, përmes instalimit të teknologjisë më moderne në njësitë e reja. Edhe ne zotohemi se “Kosova e Re” do të zbatojë praktikën më të mira të Bashkimit Evropian. Këtu vlen të përmendim respektimin e direktivave mjedisore të BE-së, të aprovuara në vitin 2017, të cilat kufizojnë në mënyrë shumë rigorozë ndotjen, si dhe realizimin e zotimeve për integrim në tregun rajonal të energjisë. Për më tepër, termocentrali “Kosova e Re” nuk është një termocentral më shumë, por është zëvendësues i pjesshëm i kapaciteteve tejet të vjetra të termocentralit “Kosova A”, që janë jashtë prodhimit dhe të planifikuara për dekomisionim. Misioni i njësisë së re është që të zëvendësojë këto njësi të vjetra prodhuese të TC “Kosova A” dhe të rrisë sigurinë e furnizimit, duke krijuar burim të qëndrueshëm të energjisë bazë.

**Dardan Sejdiu**, tha se arsyeja pse kam kërkuar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, që të na raportojë, është që të informohemi se deri ku kanë shkuar punët, sa i përket projektit për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” nga “ContourGlobal”. Prandaj, kërkesa është e thjeshtë, pra që të tregojë se deri ku keni mbërrirë me ndërtimin e termocentralit. Pyeti për

mbarëvajtjen e projektit: deri ku keni arritur, çfarë punësh ju presin për nisjen e funksionalizimit të ndërtimit të termocentralit të ri? Ndërkohë që Banka Botërore, kohë më parë, është tërhequr nga përkrahja për ndërtimin e këtij termocentrali.

**Valdrin Lluka, ministër,** sqaroi se projekti për ndërtimin e termocentralit “Kosova së Re” është duke u realizuar në bazë të planit. Ne presim që deri në fund të vitit, të marrim ofertat. Pra, ne presim që në pjesën e parë të vitit 2019, të fillojë ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re”. Tani, projekti ka filluar, është duke vazhduar në bazë të planifikimeve. Ai tha se edhe pse Banka Botërore nuk e përkrah këtë projekt, termocentrali i ri do të ndërtohet në bazë të planifikimeve. Pas ndërprerjes së përkrahjes nga Banka Botërore, “ContourGlobal” ka filluar negociatat me OPIC, ku dhe OPIC i ka dhënë dritën e gjelbër investitorit për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të aplikuar për kredi. Siç jeni të informuar, pas një procesi për mbi 10 vjet në diskutim me Bankën Botërore, ne, tashmë kemi pranuar edhe zyrtarisht vendimin që BB nuk do të ofrojë garancitë e pjesshme për projektin “Kosova e Re”. Vlen të theksohet që sipas marrëveshjeve komerciale, investitori është i obliguar që ta sigurojë financimin. Me këtë rast, 30% e financimit vjen nga ekuiteti i vetë investitorit, pastaj rreth 30% do të sigurohet nga kompania që do të përzgjidhet për EPC, si dhe pjesa tjetër nga kredi, të cilat do t’i sigurojë investitori. Sipas “ContourGlobal”, janë disa institucione financiare ndërkombëtare të gatshme për financim të këtij projekti. Këto institucione të mëdha financiare janë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Koreja e Jugut, Polonia etj.

**Dardan Sejdiu,** tha se Banka Botërore, pas refuzimit për ta përkrahur ndërtimin e këtij termocentrali, ka sjellë dhe sugjeruar alternativa të tjera, siç janë burimet e energjisë së ripërtëritshme. Kjo çështje, fatkeqësisht është vonuar. Në vend që të shqyrtohen 3-4 opsione alternative, në mënyrë që të zgjidhet opsioni më i mirë. Ai theksoi se opsioni më i mirë, do të ishte ndërtimi i kapaciteteve energjetike nga vet KEK-u, me financim të subvencionuar nga shteti. Pastaj, pyeti lidhur me garancinë e sovranitetit, çka nuk do të përfshijë kjo garanci e sovranitetit? Cila është kosto e buxhetit të Kosovës, nëse kjo garanci e sovranitetit nuk kalon? Sa ka do të jetë kostoja e kredisë për 70% të mjeteve financiare, që duhet të merren për ndërtimin e termocentralit mbi 90 milionë? Kur dihet që ndërmarrja KEDS ka për obligim që ta blejë energjinë, çka do të ndodhë, nëse nuk i blihet energjia kompanisë? A e keni llogaritur, cila do të jetë kostoja për energji alternative? A keni bërë studimin e stimulimit, nëse aktivizohet interkoneksioni me Shqipërinë, si do të shpenzohet kjo energji nga hidrocentralet?

**Valdrin Lluka, ministër,** duke u përgjigjur në pyetjet e deputetit Sejdiu, sa i përket garancisë shtetërore, koha që ne presim është diku rreth muajit prill. Nëse projekti për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” nuk kalon nga Kuvendi, Kosova rrezikon t’i humbasë 19.7 milionë euro. Ai ka bërë të ditur se kostoja e kredisë do të jetë 4.7 për qind, ndërsa kostoja e projektit alternativ nga Banka Botërore do të jetë 900 deri në 1 miliard euro. Sa i përket borxhit publik, sipas tij, kjo do të jetë 260 milionë euro. Për intrekoneksionin me Shqipërinë, tha se presim që shumë shpejt të aktivizohet, derisa të ndërtohet për 5 vite termocentrali i ri, mund ta përdorim këtë energji koha pas kohe, ashtu siç është paraparë në kohën kur kanë kapacitet mjaftueshëm të bëhet shkëmbimi i energjisë elektrike me hidrocentrale nga Shqipëria.

**Kryetarja**, tha se nuk është hera e parë që po flitet lidhur me procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova së Re”, andaj, duhet të fokusohemi në këtë çështje për këto burime të energjisë bazë që i disponojmë si shtet.

**Lutfi Zharku**, tha se kur e keni nënshkruar kontratën që për një pjesë të kredisë të investojë dhe të garantojë shteti, kur dihet që shteti, me ligj, nuk mund të hyjë në borxh publik mbi 30%, nëse kalohet p.sh. 38%. Si do të japë garanci Qeveria?

**Valdrin Lluka, ministër**, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetit Zharku, tha se gjatë negociimit kemi arritur që në kontratë të zvogëlohet garancia deri në 19.7 milionë euro. Sa i përket borxhit publik, do të jetë 260 milionë euro. Kjo shumë nuk e cenon borxhin e publik.

**Glauk Konjufca**, tha se kostoja për ndërtimin e këtij termocentrali është shumë e lartë, andaj ky koncept bazik që e ka punuar Qeveria është i gabueshëm. Kur shpërndahet kostoja e çmimit për energjinë elektrike do të jetë i papërballueshëm për Kosovën. Ai theksoi se kemi pasur problem me çmimin e energjisë, vetëm me privatizimin e KEK-ut, kemi pasur edhe protesta, sepse tejkalimi i çmimit të energjisë ka qenë i pajustificueshëm. Po ashtu, potencoi se nëse e kemi parasysh se në cilat kondita po hyn Kosova në marrëveshje, ku ia paguani të gjitha shpenzimet investitorit, atëherë marrëveshja është e dëmshme për Kosovën, pasi sipas vlerësimeve të ekspertëve, energjia elektrike do të shtrenjtohet 46 % dhe si e tillë do të jetë e papërballueshme për qytetarët.

**Valdrin Lluka, ministër**, sqaroi se po tentojnë ta balancojnë me investimet në masa eficiente të energjisë. Megjithëkëtë, deri tani institucionet në këtë kanë investuar vetëm në objekte publike dhe jo në ekonomitë familjare. Sipas kontratës, “ContourGlobal”, pas pesë vjetëve të parë të prodhimit, ka të drejtën e shitjes së asetëve. Derisa, në prill të vitit të ardhshëm, para se të nisë së ndërtuari termocentrali, projekti do të kalojë në Kuvend të Kosovës. E në rast se nuk merr shumicën e votave, atëherë Kosova do ta paguajë penalltinë e përcaktuar me kontratë prej 19.7 milionë eurosh.

**Dardan Sejdiu**, potencoi se në bazë të raporti të Zyrës së Rregullatorit për Energji, çmimi për amvisni është ngritur në rritjen e faturës për energji elektrike 56%. Gjatë negociatave për nënshkrim të kontratës, a është bërë vlerësimi në ndikimin në mjedis, ashtu siç është paraparë në Strategjinë e Energjisë? Pasi që jemi palë kontraktuese, a ka ndonjë kufizim në kontratë me kompaninë “Contour Global”, që nëse dëshiron t’i shesë aksionet, mund ta bëjë këtë gjë? Ai tha se ekzistojnë shumë alternativa, vetëm duhet që të eksploroheh metodat sesi do t’u qasemi projekteve për energji të ripërtëritshme, pa u dëmtuar ekonomitë familjare.

**Valdrin Lluka, ministër**, sqaroi sa i përket raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Për vlerësimin në ndikimin në mjedis, tha se kjo është bërë në bazë të Strategjisë së Energjisë, duke u bazuar në të gjitha pikat e parapara. Ndërsa, për shitjen e aksioneve, theksoi se kjo çështje, megjithëkëtë nuk mund të bëhet pa aprovimin e Qeverisë së Kosovës.

**Sali Zyba**, tha se është shqetësuese kjo kontratë, nëse Kuvendi i Kosovës nuk e miraton garancinë e sovranitetit, atëherë Kosova duhet ta paguajë penalltinë e përcaktuar me kontratë prej 19.7 milionë eurosh.

**Memli Krasniqi**, theksoi se kemi humbur 12 vjet dhe është i domosdoshëm ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re”, për energjinë bazë. Ai tha se nëse kompania kalon çmimin mbi 80 euro për MW, atëherë Qeveria e Kosovës e ka të drejtën e shkëputjes së kontratës. Kjo është garancia më e mirë, e mundshme që është negociuar me kompaninë “Contour Global”, për të siguruar çmimin energjisë elektrike që mos të rritet në dëm të qytetarëve.

**Valdrin Lluka, ministër**, lidhur për ndërtimin termocentralit të ri nga ana e shtetit, tha se nuk mund ta ndërtojë shteti, me kapacitetet e veta këtë termocentral, pasi që është shumë i kushtueshëm dhe kemi 2 termocentrale që na duhet t’i mirëmbajmë gjatë gjithë kohës, vazhdimisht. Ideja e kapaciteteve të ripërtëritshme, në bazë të analizave, është shumë e kushtueshme me çmimin e tregut. Prandaj, nuk guxojmë të rrezikojmë energjinë bazë nga thëngjilli, duke bërë eksperimente me energjinë ripërtëritshme. Në fund, ministri Lluka, lidhur me raportimin për funksionalizimin e ndërmarrjes “Trepça”, kërkoi, që të raportojë për ndonjë mbledhje tjetër, për shkak të një takimi të paracaktuar më herët.

**Kryetarja** falënderoi ministrin për raportimin, lidhur me procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova së Re”, ndërsa lidhur me pikën për ndërmarrjen “TREPÇA” SH.A., propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri dhe pjesë e këtij raportimi të jetë edhe Bordi i Ndërmarrjes “TREPÇA” SH.A.

*Pas debatit, komisioni nxori këtë:*

*Përfundim*

*Ministri i Zhvillimit Ekonomik, do të raportojë në komision, lidhur me procesin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”, në mënyrë që deputetët të jenë të informuar për tërë procesin e ndërtimit, ku përmes këtij raportimi, do të ushtrojnë kontroll demokratik ndaj ministrisë.*

#### **4. Të ndryshme Çështjet vijuese.**

**Kryetarja** propozoi që komisioni t’u bëjë vizita bizneseve, në bazë të planit të punës dhe në bazë të kërkesave të palëve. Kësaj radhe, propozoi që të bëjë vizitë në Ferizaj, konkretisht në “Market plus”, një biznes që tregton vetëm artikuj vendorë dhe ka filluar ta zbatojë Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, që parashihet të vendoset flamuri afër çmimit të produktit. Dhe këtë propozim e ka marrë nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës. Lidhur me këtë, propozoi që vizita të bëhet më datë 9.11.2018.

*Komisioni u pajtua me propozimin e kryetares.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:30.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

-----  
**Sala BERISHA SHALA**